



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Integrimin European*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 26.05.2015, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Taulant Balla – nënkryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Miratimi i programit të punës së Komisionit të Integritimit European për periudhën 22 maj - 12 qershor.
3. Projektligji “Për turizmin”.
4. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Taulant Balla, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Esmeralda Shkjau, Ilir Xhakolli, Sadri Abazi, Kejdi Mehmetaj dhe Gerti Bogdani.

**Mungojnë:**

Arben Imami, Edi Paloka dhe Majlinda Bregu.

**Të ftuar:**

Elda Sotiri – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Integritimit European  
Ervin Mete - zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku – këshilltar i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Sonia Popa – drejtoreshë e Përgjithshme për Turizmin në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Alma Baze – drejtoreshë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Enton Diamanti – përgjegjës sektori në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

## HAPET MBLEDHJA

**Taulant Balla** - Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 12.05.2015. Procesverbali u është dërguar deputetëve me *amil* dhe nuk ka vërejtje.

Miratimi i programit të punës së Komisionit të Integritit European për periudhën 22 maj-12 qershor të vitit 2015, të cilin e keni përpara.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Bëjini këto ndryshime, që të jenë të mërkurën.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë te projektligji “Për turizmin”.

Të ftuar, kemi zotin Ervin Mete, zëvendësministër, zotin Ardit Çollaku, këshilltar i ministrit, zonjën Sonja Popa, drejtoreshë e Përgjithshme e Turizmit, zonjën Alma Baze, drejtoreshë në Ministrinë e Ekonomisë, Enton Diamanti, përgjegjës sektori, si dhe zonja Elda Sotiri, përgjegjëse te Ministria e Integritit

Zoti zëvendësministër, ju lutem na bëni një prezantim të projektligjit “Për turizmin”!

**Ervin Mete** – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për turizmin” është pjesë e paketës së ligjeve që Ministria e Ekonomisë, tani edhe e Turizmit ka sjellë, për zhvillimin e sektorëve prioritarë dhe nxitjen e investimeve. Disa nga pikat që do të veçoja para se të kaloj te pjesa specifike e përafrimit që bën ky ligj, janë: Vendosja e standardeve të qarta në struktura turistike dhe tek operatorët turistikë në përgjithësi.

Vendosja e detyrimit për certifikimin dhe klasifikimin e këtyre strukturave.

Një rregullim i tregut për sa u përket operatorëve në përgjithësi turistikë dhe agjencive turistike.

Një kapitull i veçantë për investimet në turizëm, si dhe vendosja e standardeve dhe rregulloreve të mirëpërcaktuara, për sa i përket operimit në lëmin e turizmit.

Në pjesën e përafrimit janë 2 direktiva, të cilat përafrohen nëpërmjet këtij ligji, njëra ka të bëjë me statistikën dhe tjetra ka të bëjë me paketat turistike, të cilat përafrohen me disa akte, pjesërisht me këtë akt dhe pjesërisht me legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit, kur vjen puna te paketat, si edhe me legjislacionin për statistikën.

Faleminderit!

**Taulant Balla** – Ka pyetje të tjera nga deputetët?

Ky është ligj i ri, nuk ka pasur një ligj Shqipëria për turizmin?

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Ka pasur, por ky është ligj i ri.

Diskutime nuk ka, e hedhim në votë.

Kush është dakord, të kalojë në seancë plenare projektligji?

Miratohet.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër! Urime dhe suksese në punën tuaj!

Faleminderit, kolegëve deputetë!

Mbledhja mbyllet. Njoftimi për mbledhjen e radhës, do të bëhet nëpërmjet telefonit.

## **MBYLLET MBLEDHJA**